



## Përkujdesje mjeksore për banorët e Livoçit të Epërm

Përpjekjet e përbashkëta të aktivistëve të fshatit, kuvendit komunal dhe misionit të OSBE-së rezultuan me ndërtimin e një ambulante në Livoç

**Teksti dhe foto: Mewlyde Salihu**

Fshati Livoç i Epërm gjendet në pjesën perëndimore të Gjilanit. Rreth 3,500 banorë, shqiptarë dhe serb, jetojnë në këtë fshat. Për momentin, fshatarëve iu mungon përkujdesje mjeksore. Por ky problem i rëndë i shëndetsisë do të zgjidhet së shpejti.

Kohë më parë, aktivistët e këtij fshati iu drejtuan kuvendit komunal të Gjilanit dhe kërkuan ndihmë për ndërtimin e një shtëpie të shëndetit në fshatin e tyre. Dhe ata gjetën përkrahje. Z. Fadil Osmani, drejtor për projekte në kuvendin komunal, kontaktoi Zyrën e OSBE-së në Gjilan dhe në bashkëpunim me stafin e saj, filluan punën. Ata bënë një projekt, zyra e OSBE-së e aprovoi, siguroi të hollat dhe ndërtimi filloi. Tani, ambulanta është në përfundim e sipër dhe inaugurimi i saj pritet të bëhet në shtator.

Znj. Lola Ansele nga Departamenti për Demokratizim i OSBE-së në Gjilan thotë se misioni i OSBE-së është shumë i kënaqur me projektin dhe me mënyrën se si janë zhvilluar

gjërat. "Ambulanta do t'i shërbejë komunitetit shqiptar dhe atij serb. Mendojmë që është një projekt shumë i mirë i cili do t'u ofroj njerëzve përkujdesje më të mirë mjeksore se që kanë pasur deri më tani." Ajo shtoi se bashkëpunimi financiar në mes të OSBE-së dhe komunës ka qenë në nivelin e duhur. Komuna ka mbuluar 10% të shpenzimeve, derisa OSBE-ja 90%.

Përveç ofrimit të shërbimeve mjeksore, ambulanta do të rris numrin e të punësuarve në këtë fshat. Mjekët me siguri do të vijnë nga Gjilani, pasi që nuk ka doktor të diplomuar në Livoç, por infermieret do të jenë nga fshati. Deri tani, banorët është dashur të shkojnë në Gjilan për trajtim mjekësor. Kjo nuk do të jetë e nevojshme kur ambulanta do të filloj punën.

Përfaqësuesi i fshatit, Z. Ramadan Kurteshi, tha se ky është një projekt me rëndësi të posaçme për Livoçin. "Kemi qenë një fshat me infrastrukturë tërësisht të pazhvilluar. Tani, me punën e zellshme të aktivistëve

të fshatit, kuvendit komunal të Gjilanit dhe OSBE-së, jemi shumë afër ta kemi një shtëpi shëndeti funksionale në fshat," tha Z. Kurteshi. Drejtori i projektit, Z. Osmani, tha se banorët lokal kanë bërë një punë shumë të madhe. "Banorët i kanë thyer barrierat dhe i kanë tejkaluar ndarjet. Komuniteti shqiptar dhe ai serb janë pajtuar se zgjidhja e problemit të asistencës mjeksore në fshatin e tyre është prioritet," shtoi Osmani.

Puna e fshtarëve u shpague. Ata kanë arsye të jenë të lumtur dhe janë të lumtur. Halim Ramadani, një i ri nga Livoçi, thotë se është shumë i kënaqur derisa sheh punëtorët duke vënë kulmin e ambulantës.

Praktika tregon se kur njerëzit bien dakord mes vete, zgjidhjet janë të shpejta. Edhe pse është dashur gati një vit për të ndërtuar këtë ambulante, rezultati është mbresëlënës. Të paktën për 3,500 banorët e Livoçit të cilët në një të ardhme të afërt nuk do të kenë nevojë të udhëtojnë deri te qyteti më i afërt - i cili nuk është edhe aq afër - për të marrë ndihmë mjeksore.



Disa punëtorë duke vendosur çatinë e ambulantës së re

### KËNËNËMËR

**Intervistë me Z. Haki Demolli, Drejtor i QJK-së** faqe 2

**Një nismë e guximshme** faqe 3

**Katër atletë Kosovar në Olimpiadën Speciale** faqe 3

**Demokracia përmes valëve të Radios** faqe 4

**Intervistë me Z. Lutfi Haziri, Kryetar i AKK-së** faqe 5

**Krijoni më tepër hapsirë për femrat** faqe 6

## Një kthim i sukseshëm

U deshën disa përpjekje në mënyrë që 100 shqiptarë të Kosovës të mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre në Biti të Epërme

**Teksti: Mustafa Skenderi**

Para vitit 1999, Bitia e Epërme, fshat në komunën e Shtëpces, ishte e banuar me serb dhe shqiptarë. Katër viteve të fundit, shumica e shqiptarëve të këtij fshati kanë qenë të zhvendosur në Ferizaj dhe fshatrat përreth. Pas përmirësimit të gjendjes së sigurisë, fshatarët shqiptarë i dërguan një kërkesë bashkësisë ndërkombëtare dhe strukturave komunale që të kthehen në shtëpitë e tyre.

Kthimi i parë spontan i shqiptarëve në fshatin Biti e Epërme u bë me 9 maj. Në shenjë proteste, një numër i banorëve serb të fshatit bllokuan hyrjen e fshatit. Pas negociatave u arrit një marrëveshje se shqiptarët duhet të kthehen prapa, por ata paralajmëruan se do të provojnë të kthehen prap me 22 maj. Ndërkohë, Zyra e OSBE-së në Shtëpçecë, në bashkëpunim me

UNMIK-un, KFOR-in dhe UNHCR-in, ka filluar një fushatë vetëdijësimi dhe debate publike, me qëllim të avancimit dhe sqarimit të së drejtës në kthim. "Është e drejtë e pamohueshme e secilit komunitet që të kthehet në vatrat e tyre," thotë Z. Horst Deneke, shefi i zyrës.

"Sa i përket procesit të kthimit," thotë Znj. Spomenka Kojadinovic, anëtare e Grupit Punues Komunal, "ne nuk kemi marrë pjesë në mënyrë direkte në kthimin e shqiptarëve në Biti të Epërme." "Roli ynë ka qenë fotografimi i vendit ku ata kthehen, dhe që ky komunitet të vejë kontakte me komunitetin tjetër, të bisedojnë me njeri tjetrin, në mënyrë që ky kthim të jetë i dobishëm edhe për serbët në mënyrë që t'i përmirësojmë marrëdhëniet tona."

Rreth 100 shqiptarë të zhvendosur nga Bitia e Epërme, të përcjellur nga 20 automjete të KFOR-it dhe UNHCR-it, u përpoqën prap të hyjnë në fshat më 22 maj. Rreth 100 serbë e bllokuan hyrjen e fshatit. Gjatë ditës filluan bisedimet ndërmjet udhëheqësve politik shqiptarë dhe serbë në njërin anë, dhe në mes të banorëve të të dy komuniteteve në anën tjetër, por pa ndonjë rezultat. U arrit pajtimi që mbledhja të vazhdojë me 23 maj, kur u arrit marrëveshja përfundimtare dhe shqiptarët e zhvendosur hyjnë në fshat pa përcjellje të KFOR-it apo policisë.

Organizatata ndërkombëtare humanitare si ARC dhe UNHCR po i ndihmojnë këta njerëz të strehohen për momentin. Në ditën kur ne i vizituan të kthyerit, ata ishin duke vlerësuar materialin e nevojshëm për rindërtimin e shtëpive të tyre.

## EDITORIALI

## OSBE-ja është këtu që të ndihmoj për të Drejtat Pronësore

Në qershor 2003, Misioni i OSBE-së në Kosovë botoi një raport të gjatë mbi të drejtat pronësore. Ne e prezentuam raportin në një ndërtesë të papërfunduar me një rrëfim të jashtëzakonshëm për një ndërtesë të papërfunduar, siç ka shumë ndërtesa të kryera ose pakryera në Kosovë.

Kah mesi i të 80-ve, toka ishte pronë e një qytetari Kosovari. Ajo ishte përvësuar nga komuna, por komuna nuk i ndoqi procedurat dhe toka iu kthyer pronarit të vërtet.

Në vitin 1988, pronari e shiti tokën. Pas konfliktit, pronari filloi të ndërtoj por nuk aplikoi për leje ndërtimi. Në vitin 2001, komuna e urdhëroi që të ndal ndërtimin. Pas kësaj, pronari bëri një kërkesë që të legalizoj ndërtimin, gjë që i lejohet atij. Megjithatë, pronësia e tokës nuk mund të vërtetohet dhe komuna nuk mund të legalizonte ndërtimin.

Rasti është ende në pritje e sipër dhe pronari është duke kërkuar konfirmimin e të drejtave pronësore në gjykatë, por është vështirë të thuhet përfundim për shkak të mungesës së dokumenteve.

Egzistojnë edhe shumë raste të tjera me probleme të njëjta ligjore. Po, raportin në vijim tregon suksesin që është arritur, por ende ka pengesa.

Në mes tyre janë:

- Mungesa e provave pronësore
- Një kornizë ligjore konfuze dhe kontradiktore
- Dështimi i disa qeverive komunale që të ndjekin procedurat e shpronsimit
- Ndërtimet ilegale dhe praktikat kundërrthënëse në Kosovë kur kemi të bëjmë me këtë qëshetje
- Joefikasiteti i gjykatave kur kanë të bëjnë me konflikte pronësore; dhe
- Mborjtja e pamjaftueshme e të drejtave pronësore e minoriteteve dhe të kthyerve

Gjithashtu, duhet t'i përmendim disa fusha ku është arritur progres

• zgjidhja e kërkesave pronësore të dorëzuara në Drejtoratinë për Çështje Pronësore është përmirësuar sidomos në vitin 2003;

• bashkëpunimi brenda agjencionit është përmirësuar sidomos përmes Bordit Këshillëdhënës mbi Grupin Punues të Komisionit për Drejtat Pronësore

• Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës që merret me çështjet të lidhur me Agjencionin Kosovari të Mirëbesimit është themeluar tash kohëve të fundit. Ajo do të punoj në lidhje me mosmarrëveshjet dhe ankesat që kanë të bëjnë me



**Ambasadori Pascal Fieschi, Udhëheqës i Misionit**

privatizimin dhe procesin e rindërtimit ekonomik që është në rrugë e sipër në Kosovë.

Me vazhdimin e transferimit të kompetencave, ne presim që institucionet e përkohshme të marrin përgjegjësitë e veta në fushën e të drejtave pronësore. Ajo nuk është një detyrë e lehtë dhe nuk do të bëhet më e lehtë në vitet e ardhshme. Por, ndihma e ofruar për të gjithë njerzit e Kosovës, k me qëllim që ti kenë të qarta të drejtat e tyre dhe shtëpitë e tyre, është një pjesë e rëndësishme për ndërtimin e një të ardhme të qëndrueshme dhe paqësore për Kosovën.

Si gjithmonë, OSBE-ja do të jetë këtu për të ndihmuar.

## "Ne ofrojmë asistencë teknike institucioneve për aplikimin e ligjit"

thotë Z. Haki Demolli, Drejtor i Qendrës Juridike të Kosovës

Intervistoi: Edita Buçaj

Detaje: Duke qenë organ i pavarur nga OSBE-ja dhe me drejtor vendor, cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet QJK-ja?

Vërtetë QJK është në procesin e pavarësisht nga themeluesi i saj respektivisht nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - Misioni në Kosovë, mirëpo kjo nuk do të thotë se QJK do të shkëpusë të gjitha lidhjet dhe bashkëpunimin me OSBE-në. Aktualisht, një ndër sfidat kryesore të saj është përpilimi dhe realizimi i një strategjie afatgjate, që do të bënte QJK-në organizatë të qëndrueshme dhe stabile. Prioritetet gjatë përpilimit të kësaj strategjie padyshim do të jenë arsimimi me çështje ligjore, ngritja e vetëdijes ligjore të kategoritë e caktuara të qytetarëve, trajnimi ligjor dhe botimi e publikimi i revistave, librave dhe përmbljedhjeve nga lëmia e drejtësisë.

Detaje: QJK-ja luan rol të rëndësishëm në reformimin e Fakultetit Juridik. Sa është arritur në këtë drejtim dhe a mund të thuhet se do të ketë përmirësim të shpejtë në të ardhmen?

Që nga viti 2000 QJK ka qenë e emëruar nga ish Departamenti i Arsimit dhe Shkencës që të udhëheqë me procesin e reformave në Fakultetin Juridik të Prishtinës. Kjo reformë është



**Z. Haki Demolli, Drejtor i Qendrës Juridike të Kosovës**

bazuar në Deklaratën Evropiane të Bolonjës. Në kuadër të reformave të përgjithshme në FJP, është paraparë zhvillimi dhe avancimi i planprogrameve, reformimi i modelit të studimeve, përfshirja e specializimeve të reja në studimet e drejtësisë, përfshirja e programeve të praktikës juridike, avancimi i metodave të vlerësimit të studentëve etj. Përkundër vështirësive të paraqitura, pjesë të caktuara të reformës janë aplikuar dhe tani modeli i studimeve në Fakultetin Juridik të Prishtinës është i njëjtë me "Modelin e Bolonjës". Poashtu, në vitin akademik

2003/2004 presim që të startojmë me gjeneratën e parë të studimeve pasdiplomike.

Detaje: QJK u ndihmon studentëve kosovar që të studiojnë jashtë vendit dhe të fitojnë përvoja të reja nga vendet më të zhvilluara? Çfarë ndodh me ta pas kthimit në Kosovë? A bëhet diçka nga ana e juaj apo edhe organeve tjera vendore për t'u siguruar vende pune në institucione?

Pas marrëveshjeve të nënshkrara me Universitetet e vendeve të tjera, QJK ka arritur që t'ju ndihmojë 22 studentëve kosovarë për të vazhduar studimet e tyre jashtë vendit (Holandë, Austri e gjetiu), qoftë në ciklin e studimeve themelore apo në ciklin e studimeve të magjistraturës. Pas kthimit të tyre në Kosovë, ata me përvojat e fituara gjatë studimeve jashtë vendit, në një mënyrë apo në tjetrën në rrethanat ekzistuese kanë një përparësi në raport me kolegët e tyre që nuk kanë pasur mundësi për studime jashtë vendit. Dhe zakonisht në kushtet ekonomisë së tregut kjo kategori e juristëve ia del që të plasohet më mirë dhe të sigurojë vende më të mira të punës, kurse disa prej tyre, pas kthimit në Kosovë kanë qenë dhe janë të angazhuar drejtëpërdrejtë në implementimin e projekteve të ndryshme të QJK.

Detaje: Qendra juaj bën përmbljedhje të ligjeve të aplikueshme në Kosovë. Sipas raporteve të ndryshme të bëra në lidhje me sistemin gjyqësor në Kosovë, burimi i trefishtë i legjislacionit e vështirëson punën e gjykatave dhe është shpesh kontradiktor. Cilat janë vërejtjet tuaja gjatë përmbljedhjes së këtyre ligjeve?

Deri me tani QJK ka botuar 5 vëllime të përmbljedhjeve të ligjeve dhe të dispozitave të tjera që aplikohen në Kosovë, në gjuhën angleze, shqipe dhe serbokroate. QJK me botimin e përmbljedhjeve të tilla kryen vetëm një shërbim që mund të thuhet të natyrës teknike për institucionet të cilat i zbatojnë, komentojnë, analizojnë dhe studiojnë ligjet. Njëherit QJK bënë edhe distribucionin falas të përmbljedhjeve të tilla. Për shkak se QJK drejtëpërdrejtë nuk bënë aplikimin e dispozitave ligjore që botohen në këto përmbljedhje, është e logjishme që edhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje konkrete rreth këtyre ligjeve. Ndërsa shiqur nga aspekti i analizimit dhe komentimit të këtyre dispozitave ligjore, mund të them se bashkëpunëtorët profesional të QJK jo rrallë shprehin mendimet, vërejtjet dhe sygerimet e tyre profesionale të cilat ne si Qendër i botojmë në revistën tonë periodike "Studimet Ligjore të Kosovës".

DEAE  
DEALS  
DEALI

Rruga Beogradit 32 38000 Pristina  
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
E-mail: press@omik.org

Botuesi:  
Poul Smidt  
Kryeredaktor:  
Florin Pasnicu  
Redaktor:  
Hasan Sopa (Detaje)  
Slavica Mladenovic (Detalji)  
Dizenji & faqesja  
Shpend Kada

Bashkëpunëtorët:  
Srdjan Antic, Chris Cymannick,  
Arijan Haxhibegri, Xheme Ibraj,  
Vlera Kastrati, Rexhep Krasniqi,  
Sven Lindholm, Nderim Pasuli,  
Ivana Petrovic, Gozdim Rexha,  
Halide Sadiku, Mervide Salihu,  
Andrej Sever, Mustafa Skenderi,  
Slavica Staletovic, Armend Tahirsylaj,  
Irfan Ukshini, Bernard Vrbani

OSCE  
Mission in Kosovo

Shënim:  
Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politiken, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

# Një nismë e guximshme

Ekspertë vendor dhe ndërkombëtarë diskutojnë sfidat e reformimit të qeverisë lokale

**Teksti: Leon Malazogu dhe Besnik Tahiri / foto: Hasan Sopa**

Prej dhjetorit të vitit 2002 deri në qershor të vitit 2003, misioni i OSBE-së dhe Instituti i Kosovës për Hulumtime të Politikës dhe Zhvillimit (KIPRED) kanë organizuar tri tryeza të rumbullakëta/konferenca në lidhje me reformimin e qeverisë

jerues. Të tri mbledhjet u kryesuan nga një ekspert vendor, që i kontribuoi shumë debatit të udhëhequr nga vendorët. Një numër i organizatave tjera vendore morën pjesë dhe ishin aktive në panele të ndryshme. Kosovës i mungon tradita në ve-

shoqëria civile mund të bëjnë zgjedhje më të lehtë të zgjidhjeve më të mira për Kosovën.

Në këtë mënyrë konferencat synojnë të arrijnë krijimin e ambientit për analiza të politikës, duke vënë një kornizë pak më akademike në rend të parë. Përkundër kontekstit shumë të ngarkuar politikisht të decentralizimit, kjo arriti t'i bindë pjesëmarrësit e interesit se është "reforma e qeverisë lokale" ajo për çka duhet biseduar. Mënyra se si një ekspert ndërkombëtar me një njohuri të gjërë për Kosovën do t'a formulonte, "ne duhet t'a democionalizojmë dhe de-iracionalizojmë këtë".

Në këto konferenca u analizuara çështje të ndryshme. Fillimisht, çështjet ishin të gjëra dhe konceptuale. Me përparimin e konferencave, ato redukoheshin në tema më specifike siç janë: korniza ligjore edhe ligjet kontradiktore; si është bërë ky proces në vende me përvojë të ngjashme; çfarë është roli i transferimit të kompetencave; çfarë janë ngatërresat financiare, etj. Një numër i ekspertëve nga Sllovenia, Zvicra, Austria, Hungaria, Maqedonia kontribuan shumë në këtë përpjekje. Në tryezën e rumbullakët përfundimtare, Këshilli i Evropës shpалosën projektin e parë të modelit që ata e mendojnë të jetë i përshtatshëm për Kosovën.

Në përgjithësi, të gjithë pjesëmarrësit mësuën në këto konferenca. Ata morën shumë shembuj me rëndësi, dhe vunë përpara frikën dhe preferencat e çdokujt. Kjo u mundësoj ekspertëve të bëjnë modele dhe t'i testojnë ato. Këshilli i Evropës paraqiti modelin e preferuar. Sidoqoftë, Misioni i OSBE-së dhe KIPRED do të punojnë ngushtë me Këshillin për vazhdimin e debatit. Ata do të kordinojnë bashkërisht një numër aktivitetsht të organizatave dhe donatorëve tjerë, në mënyrë që të arrihen rezultatet që do të jenë të dobishme për ardhmërinë afatgjate të njerëzve të Kosovës.



Ekspert vendor dhe ndërkombëtarë, gjatë një sesioni të mbajtur në zyrën qendrore të OSBE-së në Prishtinë

lokale. Diskutimi filloi me temën e decentralizimit, pasi që kjo temë kishte filluar muaj më parë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral të KB që t'a motivojë komunitetin serb të merr pjesë në zgjedhjet lokale. Por, së shpejti u pa se decentralizimi ishte proces shumë më kompleks dhe më i gjatë, nepër të cilin duhet të kalojë Kosova, pavarësisht nga tensionet etnike. Si rezultat i kësaj, konferencat vijuese kishin të bënin me "reformën e qeverisë lokale", retorikë e pranuar gjithashtu nga Misioni i Decentralizimit i Këshillit të Evropës.

Këto konferenca kishin për qëllim të mbledhin ekspertë vendor e ndërkombëtarë, ekspertë të përfshirë në qeverinë lokale në Kosovë dhe në vende të rajonit që kanë pasur përvojat të ngjashme. Fillimisht, projekti përfshinte një grup të vogël akademik. Konferenca e dytë dhe e tretë gjithashtu përfshiu pjesëmarrës të tjerë me interes të përbashkët dhe sug-

tëqeverisjeje autonome. "Komunat jugosllave" të Kardelit, të decentralizuara në shkallë të lartë, ishin shumë më tepër shembull i autoritetit "të dekoncentruar" të shtetit se sa qeveri lokale. Me vendosjen e UNMIK-ut, qeverisja komunale u adresua me Rregulloren 2000/45. Pasiqë kjo rregullore u zëvendësua me shumë rregullore të tjera, sot ekziston një konfuzion në lidhje me 23 detyrat dhe obligimet e komunave. Kësaj i shtojmë tensionet etnike dhe kapacitetet e ulta financiare të komunave, që lidhen me pritjet e mëdha të njerëzve. Si rezultat i kësaj, KIPRED dhe Misioni i OSBE-së, vërejtën nevojën e stimulimit të një debati publik dhe procesi politik me një diskutim të pavarur shkencor. Kjo u paraqiti si e domosdoshme në mënyrë që të identifikohen çështjet substanciale dhe të sigurohet një mençuri nga ana e ekspertëve dhe akademikëve. Në këtë mënyrë mund të skicohen alternativat dhe politikanët dhe

# Katër atletë Kosovar marrin pjesë në Olimpiadën Speciale

"Të përpiqëm të fitoi, por nëse nuk fitoj, të paktën do ta provoj" është motoja e Lojrave Olimpikë

**Teksti dhe foto: Hasan Sopa**

E ejtja e 12 qershorit do të jetë një ditë që do të mbahet mend për një kohë të ngjashme të bashkangjitet njerëzve me aftësi të kufizuara në Kosovë. Por, katër prej tyre kurrë nuk do ta harrojnë këtë ditë. Kjo është diçka që ata asnjëherë nuk kanë ëndërruar, por u bë realitet në sajë të një numri të vogël njerëzish që bënë përpjekje maksimale. Nga 16 dhe deri më 29 qershor ata do të marrin pjesë në Olimpiadën e Lojrave Speciale Botërore që do të mbahen në Dublin të Irlandës. Nuk është me rëndësi se kush fiton apo humb, me rëndësi është pjesëmarrja.

Garat sportive të kësaj Olimpiade do të kenë një ndikim pozitiv nga shumë aspekte në jetën e atletëve. Do të ndikojnë në rritjen e vetëbesimit dhe mundësisë së shoqërimit në jetën e përditshme, do t'i përgadis për një jetë të pavarur dhe do të ndikoj në përmirësimin e marrëdhënieve shoqërore dhe famil-

nga Gjakova, sot është tejet e lumtur. Fjalët janë të pakta për t'i shprehur ndjenjat që ka. Djali i saj Adnani është njëri nga katër atletët që do t'i bashkangjitet ekipit të Kosovës për në Dublin. "Kjo do me thanë shumë për fëmijë dhe nuk di as se si me u shpreh. Njëherë fëmija me dal dhe me u shoqërua me shokë të tjerë, mos me ndejet vetëm në shtëpi i mbyllur," shprehet e gëzuar Zade Ibrahim.

Komuniteti irlandez që përfaqëson organizata të ndryshme ndërkombëtare në Kosovë, ka dhënë ndihmesë të madhe për dërgimin e ekipit të Kosovës në Dublin. Z. Wiliam Egar, koordinatori i zyreve të OSBE-së në teren, thotë se janë krenar dhe të lumtur për punën që kanë bërë. Ai mendon se ky grup i vogël që do të

udhëtoj për në Dublin simbolizojnë së shoqërimit në jetën e përditshme, do t'i përgadis për një jetë të pavarur dhe do të ndikoj në përmirësimin e marrëdhënieve shoqërore dhe famil-



Katër atletë (ulur), që do të marrin pjesë në Olimpiadën Speciale në Dublin

jare. Me fjalë të tjera, ata jo vetëm që do të pranohen si atletë por edhe si antarë të qmuar të shoqërisë. Nuk ka dyshim se do të ndikojnë edhe në jetën e tyre, pasi që do i bartin ato në jetën e tyre të përditshme në familje, në shkollë, në punë dhe në mjedisin ku ata jetojnë. Jo vetëm këta katër atletë por edhe familjet e tyre do ta kujtonë këtë ditë dhe kurrë nuk do ta harrojnë. Zade Ibrahim

ndihmon të gjithë njerëzve me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Shënim:

Reprezentuesja e Kosovës Nurije Shabani pardoje zuri vendin e tretë në garën e vrapimit në 100m në garat botërore të Olimpiadës Speciale të cilat po mbahen në Dublin të Irlandës. Në garën tjetër të vrapimit në 400m, reprezentuesja e Kosovës Afërdita Hasani zuri vendin e gjashtë.

# Biçikleta për fëmijë

**Teksti dhe foto: Andrej Sever**

12 nxënës të cilët kanë marrë pjesë në programin për vetëdijësim në trafik janë shpërblyer me një çmim të këndshëm për pushimet verore.

Qendra Juridike e Kosovës (QJK), e themeluar nga OSBE-ja, para disa muajsh ka botuar një broshurë të quajtur "Pasaportë e Jetës Sime" kush-tuar nxënësve të shkollave fillore të rajonit të Prishtinës. Qëllimi kryesor i kësaj broshure

është t'i njoftoj nxënësit me rregullat e trafikut. Projekti është paraparë të përfundojë në gjysmën e parë të qershorit, me një varg "tërheqesh llotarie" ku nxënësit kanë pasur rastin të fitojnë biçikleta.

Një nga fituesit fatlum të tërheqjes së 11 qershorit është Marina Andrejevic, e cila është në klasën e pestë të shkollës fillore "Sveti Sava" në Shushicë. Marina thotë me krenari se nga "Pasaporta" ka mësuar se është e sigurt të ecësh në anën e

majtë të rrugës dhe të veshësh rroba të ndritshme gjatë natës. Gëzimi i saj e shtyri Z. Boro Dragovicin, drejtor i shkollës të thotë, "momentet kur shohim buzëqeshje të mëdha në fytyrat e nxënësve tanë janë të rralla."

"Mësuesit dhe prindërit e mirëpritën broshurën," thotë Aleksandra Dimitrijevic, Këshilltare Vendore në QJK. Vazhdimi i programit, bazuar në fjalët e saj, varet nga donatorët.



Marina (majtas) është fituese fatlume e një biçiklete

## Kuvendarët marrin pjesë në një seminar mbi mediat

**Teksti: Nderim Pasuli**

Mungesa e njohjes së përgjithshme të situatës mediale, në disa raste i sjell në pozitë të palakmueshme qarqet e ndryshme politike dhe qeveritare në nivelin lokal, por edhe qytetarët dhe vetë gazetarët sa i përket ligjeve, rregulloreve dhe standardeve për media. Më së shumti vërehet fakti i mosdijes për autoritetin qendror në rregullimin e regjimit medial, gjegjësisht për procedurën e ndarjes së frekuencave dhe dhënies së lejeve të punës për medime elektronike nga ana e komisionerit të përkohshëm për media. Ky institucion po ashtu bën shqyrtimin e ankesave kundër medimeve elektronike dhe të shkruara.

Për këtë arsye zyra e demokrazimit, seksioni për media pranë OSBE-së në Prizren është

duke mbajtur një varg seminaresh për trajnimin e anëtarëve të kuvendeve komunale dhe të drejtorëve komunal. Trajnimet e këtilla janë mbajtur në Prizren, Suharekë dhe Dragash, ndërsa në Rahovec dhe Malishevë do të mbahen ditën e enjte me 26 qershor, respektivisht me 3 korrik. Një temë e cila ka nxitur një interesim të madh ishte ajo për rëndësinë e konferencave për shtyp dhe shkathrësitë e intervistimit të anëtarëve dhe të drejtorëve të kuvendit komunal. Është mendim i të gjithëve se përmirësimi i imazhit të institucioneve lokale ndaj publikut dhe qasja më e mirë e tyre ndaj medimeve është një temë e rëndësishme e cila duhet të përforcohet dhe të pasurohet nga ana e institucioneve lokale.

Përpos temave të lartpërmendura, janë trajtuar edhe ato për marrëdhëniet ndërmjet gaze-

tarëve, qeveritarëve dhe anëtarëve të kuvendit, si dhe problemet që shkaktohen si rezultat i raportimit mashtrues dhe të pavërtetë. Pastaj raportimet me prapavijë politike dhe dallimi ndërmjet lajmit, opinionit dhe komentit redaktorial. Rëndësi të posaçme ka pasur edhe shtjellimi i rolit të gazetarit, respektivisht të medimeve në zhvillimin e shoqërisë.

"Mediimet demokratike dhe të përgjegjshme luajnë një rol të rëndësishëm në tensionimin apo shtensionimin e situatës së përgjithshme. Niveli i përgjithshëm i zhvillimit të medimeve reflektohet në zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe anasjelltas," thotë z. Zenu Çelaj, zëvendës kryeredaktor në gazetën ditore Zëri, në cilësinë e ligjëruesit special në këtë seminar.

## Vallëzimi për pajtim

Mysafirë të mbledhur festojnë përfundimin e programit të përbashkët nëntë mujor në Shtime

**Teksti dhe foto: Hasan Sopa**

Pizzeria "Morigona" që gjendet në qendër të qytetit ishte përplot me mysafirë të mërkurën e 11 qershorit. Kësaj radhe mysafirët kishin ardhur për të përcjellur përfundimin e suksesshëm të programit të përbashkët që kishte zgjatur nëntë muaj. Çdo gjë ishte gati, skena ishte përgaditur, mysafirët ishin të ulur dhe pijet të ser-

Muzika filloi dhe grupi i parë i valltarëve doli në skenë. Edhe pse ata ishin nxënës të shkollave fillore, luajtën me mirë se sa që pritej. Më e rëndësishmja ishte se publiku i mbledhur u nda i kënaqur me shfaqjen dhe kjo vërehej më së miri nga duartrokjet që ata i morën në fund të shfaqjes. Ishin grupe valltarësh nga të dy komunitetet, shqiptarë dhe ashkali, ku vallëzuan vallet e tyre tradicionale.



Te rinjtë nga Shtimja duke vallëzuar në proramim festiv

vuara. Grupe të ndryshme valltarësh ishin veshur me veshjet e tyre tradicionale dhe po bëheshin gati për të filluar shfaqjen.

Udhëheqësi i programit lajmëroi hapjen e programit dhe që në fillim ftoi për një fjalim të shkurtë z. Margareta Matiq, shefe e zyrës së OSBE-së në Lipjan. z. Matiq i përshëndeti mysafirët në mesin e të cilëve ishin edhe përfaqësuesit e pushtetit lokal dhe theksoj rëndësinë e procesit të pajtimit dhe se rinia më së miri mund të kontribuojë me organizimin e programeve të tilla. "Në përgjithësi muzika në të gjitha vendet e botës i bashkon njerëzit", tha z. Matiq.

Ky trajnim u organizua dhe financua nga OSBE-ja dhe është implementuar bashka-rihet me partnerin implementues "Qendren e Rinisë" në Shtime. Përveq programeve të vallëzimit dhe shoqërimin, janë organizuar edhe kurse kompjuterike, të mësimin të gjuhës angleze, dhe kurse të vizatimit. Trajnime të këtilla do t'ju ndihmojnë të rinjëve në shkollë, por edhe në jetën profesionale. Aq më tepër kjo do i stimuloi të gjithë e në veçanti komunitetin Ashkali që të arsimohet, pasi që kjo do ju ofroj raste më të mira punësimi, kushte më të mira jetese dhe integrim të plotë në shoqërinë që ata jetojnë.

## Demokracia përmes valëve të radios

Një radiostacion organizon diskutime të drejtpërdrejta me zyrtarë lokal

**Teksti dhe foto: Hasan Sopa**

Edhe përkundër përmirësimit të klimës shoqërore në pjesën më të madhe të Kosovës, ende nuk udhëhiqet në bazë të parimeve që janë esenciale për praktikën demokratike të ngjashme me ato të qeverive dhe shoqërive perendimore. Edhe pse kanë kaluar katër vite që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, komunat e Kaçanikut, Ferizajt, dhe Shtëpcës kursesi të funksionojnë në bazë të principeve demokratike.

"Radio Kaçanik-u", në bashkëpunim me departamentin për demokrazim në zyrën e OSBE-së në Shtëpcë kanë përpiluar një projekt të quajtur "Diskutimi mbi Demokracinë", që në një periudhë kohore prej gjashtë muajesh do të ftojë akterë të ndryshëm të shoqërisë për t'i diskutuar shqetësimet e përbashkëta dhe zgjidhjet e mundshme me interes kolektiv. Ky diskutim ka për qëllim përmirësimin e mënyrës së komunikimit dhe shkëmbimin e informave të vlefshme në mes të përfaqësuesve komunal të zgjedhur dhe qytetarëve.

Sipas z. Bedri Eleziti, kryeredaktor i "Radio Kaçanik-ut" projekti është përpiluar në bashkëpunim me OSBE-në. Ideja kryesore është që t'i inicioj diskutimet mbi tolerancën, transparencën, të drejtën për kthim, barazinë gjinore, të drejtat e qytetarëve dhe roli i medieve përgjegjëse me qëllim të fokusimit të diskutimeve mbi një numër sa më të madh të problemeve dhe shqetësimeve të shoqërisë.

Z. Bedri Elezi shpjegon se secila temë ka katër emisione dhe

ne secilin emision shtjellohen tema të ndryshme. "Sot ishte programi i dytë nga tema e parë ku tre liderët e partive më të mëdha në Kaçanik (LDK, PDK, AAK), diskutuan rreth bashkëpunimit ndërpartiak dhe si të tejkalohet bllokada politike si rezultat i së cilës edhe pas gjashtë muajve ende nuk funksionon qeveria lokale", thotë z. Elezi.



Habib Shehu (LDK) dhe Shukri Luta (AAK), gjatë një debati në radio

Gjatë programit u emituan intervista me qytetarë që vërehet qartë se ata aspak ops fare nuk ishin të kënaqur me nivelin e bashkëpunimit në mes të partive politik. Disa dhanë edhe kritika të ashpra. Njëri nga të intervistuarit shprehet se nuk ka kurrfarë bashkëpunimi në mes të partive politike. "Kjo më së miri vërehet me mosfunksionimin e qeverisë lokale edhe pas një periudhe prej gjashtë muajve. Ata fajësojnë njërijetrin, por në fakt ata të gjithë janë përgjegjës dhe nëse vazhdojnë të sillen në

këtë mënyrë në zgjedhjet e ardhshme populli nuk do të dalin fare në zgjedhje," shprehet qytetari i mllefosur.

Të gjithë mysafirët Fadil Qalaku (PDK) Habib Shehu (LDK) Shukri Luta (AAK), pranuan kritikën dhe u shprehën se qytetarët kanë të drejtë të jenë të pakënaqur, por ata besojnë se organizimi i projekteve të tilla

do t'i ndihmonin situatës. "Përshtypjet e mia për këtë emision janë shumë të mira. Ky emision më duket se hyn në radhën e emisioneve të aktualiteteve që janë shumë të domosdoshme për qytetarë. Partitë politike nganjëherë janë shumë të ngurta dhe nuk çojnë mesazhe tek qytetarët. Përmes këtij emisioni kemi pasur rastin që t'i njoftojmë ata me rrjedhën e ngjarjeve që kanë ekzistuar deri me tani. Prandaj jam i befusuar për të mirë dhe shpresoj se do të ketë edhe emisione të tjera," thotë Shukri Luta (AAK)

## Lufta për transparencë

Gjashtë OJQ-të nga Mitrovica kanë ndërmarrë hapin e duhur në drejtim të bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet komunës dhe shoqërisë civile.

**Teksti: Sevdije Buçinca**

Transparenca është tipar i qeverisjes së mirë dhe e shton përgjegjësinë dhe besimin e qeverisë lokale. Edhe sipas rregulloreve të UNMIK-ut mbi vetëqeverisjen, qytetarët kanë të drejtë të kenë qasje në informata në lidhje me punën dhe aktivitetet e qeverisë lokale. Qytetari ka nevojë të informohet, jo të injorohet, siç është praktika e tanishme. Bazuar në këto parime, një numër i OJQ-ëve të vendit dolën me idenë e formimit të rrjetit të OJQ-ëve për monitorimin e punës së Asamblesë Komunale.

Qendra Burimore e OJQ-ëve, Iniciativa e Mitrovicës për Përkrahje të OJQ-ëve (IMPOJQ) në bashkëpunim me Departamentin e Demokrazimit pranë OSBE-së dhe Institutit Demokratik Kombëtar (IDK) inicuan formimin e "Rrjetit të OJQ-ëve për Monitorim", që përbëhet prej gjashtë OJQ-ëve vendore nga Mitrovica:

"IMPOJQ", "Paqdashësit", "Përlumbat e Paqes", "Organizata për Humanitet", "Handikos", "Qendra e Rinisë".

Anëtarët e këtij rrjeti monitorues kanë përvojë paraprake dhe njohuri mbi strukturën komunale dhe para se të fillojnë punën praktike ata ndoqën një varg trajnimesh në lidhje me "Monitorim dhe Avokim", të udhëhequra nga IDK.

Zbatimi i projektit filloi me 1 maj 2003 në baza vullnetare. Komuna e mirëpret këtë iniciativë dhe e ndihmon punën e rrjetit monitorues. Sipas Eliza Bitiq-Shukriu, udhëheqëse e OJQ-es "MINGOS", kjo iniciativë doli të jetë hapi i parë i duhur në drejtim të bashkëpunimit më të ngushtë dhe transparencës ndërmjet Komunës dhe aktorëve të shoqërisë.

Gjatë zbatimit të këtij projekti do të ipen raporte të rregullta publike si dhe do të organizohen debate të hapura, tryeza të rumbullakëta dhe konferenca.

# “ Asociacioni ynë drejtpërdrejt përfaqëson interesin e komunave ”

thotë Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, z. Lutfi Haziri

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka ardhur si organizim menjëherë pas zgjedhjeve të para, me tendencë që pushteti lokal në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal të fillojë me zgjidhjen e problemeve të përbashkëta

Teksti dhe foto: Hasan Sopa



Z. Lutfi Haziri, kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës

“Qarkullimi i lirë i njerëzve dhe i mallrave është problemi dhe pengesa kryesore që i pengon integrimet e përgjithshme në këtë regjion”, thotë z. Haziri. Ai mendon se bashkëpunimi në infrastrukturë, krijimi e kush-

teve më të mira për qarkullim të lirë të mallrave dhe njerëzve, do të ndihmojë që ky regjion që viteve të fundit ka qenë regjion i krizave dhe luftimeve të kthet në regjion të paqes dhe stabilitetit.

Duke folur rreth iniciativës për një bashkëpunim ndërkufitarë në regjion z, Haziri thotë se ekzistojnë dy zhvillime në këtë drejtim. “Zhvillimi i parë është se Këshilli i Evropës ka hupur zyrën për zhvillim dhe demokratizim lokal në Gjilan, që mbulon të gjitha komunat e Kosovës dhe disa komuna të regjionit. Kjo ka për qëllim afirmimin e vetëqeverisjes lokale dhe të involvimit të grupeve të ndryshme shoqërore në vendimarrje. Zhvillimi i dytë pozitiv janë integrimet regjionale. Kosova përmes iniciativës tonë është pranuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitarë, iniciativë e cila është në kuadër të proceseve integruese në Unionin Evropian. Si dhe bashkëpunimi ndërkufitar në mes të Kosovës, disa komunave të Serbisë, të Maqedonisë dhe dy komunave të vogla të Bullgarisë”, shpjegon Lutfi Haziri.

Në relacionin e mbrendshëm, ky subjekt në bashkëpunim me kryetarët e komunave ka

arriur të bëjë përfaqësim më të denjë të komunave pranë institucioneve ndërkombëtare dhe institucioneve të vetëqeverisjes së përkohshme. “Me kryeministrin e Kosovës kemi nënshkruar edhe marrëveshjen mbi principet e përbashkëta mbi strategjinë e kthimit të të gjithë atyre që për arsye të caktuara e kanë lëshuar Kosovën dhe sot ata janë të zhvendosur apo refugjatë diku. Ne gjithashtu jemi pjesë aktive e diskutimit publik të reformave të administrimit civil apo decentralizimit, i cili tani si term më nuk po përdoret sepse Kosova nuk ka çka të decentralizoj në kuptimin çfare është menduar në fillim. Roli i asociacionit ka qenë kapital edhe në identifikimin e problemeve me të cilat ballafaqohen komunat si dhe identifikimin e shumë çështjeve që për nivelin qendror dhe për Këshillin e Evropës kanë qenë të pa njohura. Pra, AKK-ja është përfaqësuesi i vetëm dhe i drjtëpërdrejtë i interesit të komunave të

Kosovës”, përkujton z. Haziri.

“Në anën tjetër ne jemi aktivë në përfaqësimin e organeve lokale në kongresin e pushtetit lokal dhe regional në Strasburg, ku përfaqësohen të gjitha shtetet dhe Kosova është në cilësinë e vëzhguesit. Duke patur një pozicion specifik të administrimit ndërkombëtar në Kosovë, kemi arrit t’a avancojmë pozitën tonë nga statusi special në atë të vëzhguesit. Ne mendojmë ta avancojmë edhe më tutje këtë status, por me rëndësi është se komunat janë të parat ato që përfaqësohen në Këshillin e Evropës. Pra, ky asociacion jo vetëm që ka inkurajuar dhe mbështet bashkëpunimin ndërkomunal, por ka vazhduar ta mbështesë edhe bashkëpunimin në mes të komunave të Evropës juglindore dhe të Evropës në përgjithësi, me të cilin tani shumica e komunave të Kosovës kanë partneritet aktiv, përfundon z. Lutfi Haziri.

## Rihapet biblioteka shkollore në Osojan

Ajo gjithashtu do t’i shërbejë fshatarëve nga Biqa dhe Grapci.

Teksti: Zekije Kelmendi foto: Max Seelhofer

Projekti për rihapjen e bibliotekës shkollore në Osojan arriti një përfundim të suksesshëm nëntë muaj pas parashtrimit të kërkesës. Biblioteka u përrua më 4 qershor 2003 para përfaqësuesve të OSBE-së, mësuesve të Istogut, një numri të konsiderueshëm të lexuesve të ardhshëm dhe spektatorëve. Osojani është lokacioni i kthimit të organizuar të serbëve të Kosovës. Për momentin fshati banohet nga rreth 350 banorë dhe ka 30

nxënës që ndjekin mësimet në shkollën e fshatit.

Projekti përbëhet nga tri pjesë kryesore: renovimi i një ish-klase të madhe (60 m2) në katin kryesor, blerja e librave si dhe inventarit për bibliotekë. 2250 tituj janë blerë (shkolla ka dhuruar edhe 600 tituj tjerë nga fondi i saj) dhe Berti, një ndërmarje e vogël nga Gorazhdevci, ka kryer renovimin nën mbikqyrjen e Menagjerit Nder-

tes pranë Zyrës së OSBE-së në Pejë. Buxheti i tërësishtëm i projektit ishte 22, 240 Euro.

Biblioteka ofron një shumëllojshmëri librash, siq janë novelat, fjalorët, enciklopeditë, libra të shkencës popullore etj. Fshatrat që flasin gjuhën serbo-kroate në këtë luginë, Biqa dhe Grapci, gjithashtu mund të përfitojnë nga biblioteka që është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të infrastrukturës shoqërore në këtë lokacion me serbë të kthyer të Kosovës.



Z. Dragana Petrovic, përgjegjëse në librari, dhe njëri nga lexuesit e saj të rinjë.

## Rivendosja e marrëdhënieve të mira

Iniciativa e bashkëpunimit ndërkufitar në Dragash hap rrugën për zgjidhjen e problemeve të vjetra.

Teksti: Mustafa Skenderi

Me hapjen e dy pikë kalimeve kufitare me Shqipërinë në fshatrat Orqushë dhe Krushevë në komunën e Dragashit, zyrtarët lokal patën për qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet fshatrave gorane në komunën e Dragashit, fshatrave të Kosovës dhe gorane në komunën e Shishtëvcit dhe Zapodit në Shqipëri.

Zyra e OSBE-së në Dragash dhe zyra e OSBE-së në Kukës, Shqipëri, e inicuan mbledhjen e parë ndërmjet përfaqësuesve të komunës së Dragashit dhe të Kukësit. Në mbledhje ishin të ftuar edhe përfaqësuesit e fshatrave kufitare nga Kosova dhe Shqipëria. Mbledhja, që kishte për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit, u mbajt në Dragash në janar të këtij viti.

Bashkëpunimi ndërkufitar ka për qëllim zgjidhjen e problemeve afatgjata, siq është prerja ilegale e drunjtve dhe kalimi ilegal i kufirit për kullojtë të bagëtisë. Njëri prej takimeve pati për rezultat vendosjen e linjës direkte ndërmjet përfaqësuesve të Dragashit në Kosovë dhe të Shishtëvcit në Shqipëri, ashtu që informatat

në lidhje me ndonjë incident të mund të shkëmbehen dhe t’i përcillen shpejt policisë kufitare.

“Me hapjen e dy pikë kalimeve kufitare në fshatrat Orqushë dhe Krushevë, situata është përmirësuar dukshëm,” thotë Uzair Hamza në Zyrën e Kontaktit në Dragash. Rritja e numrit të njerëzve që i përdorin ato konfirmon dobësi e këtyre pikë kalimeve. Numri i thirrjeve telefonike në linjën direkte tregon se numri i incidenteve ka rënë.

Deri më tani janë mbajtur katër mbledhje dhe bashkëpunimi do të zgjerohet edhe në fshat tjerë. Gjatë mbledhjes së fundit janë diskutuar hapat që do të ndërmerren në drejtim të bashkëpunimit kulturor dhe sportiv. Goranët nga të dy anët e kufirit shprehin se ky bashkëpunim do t’a zhduk murin në mes tyre që ka ekzistuar vite me rradhë. Kjo do të jetë veçanërisht e rëndësishme pasi që është i njohur fakti se shumë prej tyre kanë të afërmi në anën tjetër të kufirit. Iniciativa për bashkëpunimin ndërkufitar është një rast për të gjithë që t’i rikthejnë marrëdhëniet e tyre të mira.

## Organizatrat rinore të Kosovës dhe Serbisë nxisin dialogun

Në takimin e dytë të OJQ-ve rinore rajonale diskutohen disa projekt-propozime të përbashkëta.

**Teksti: Besnik Tahiri**

Takimi i dytë OJQ-ve rinore nga Kosova dhe Serbia u zhvillua në Novi Sad kah fundi i majit. Projekti i quajtur Dialogu Civil është jetësuar nga Qendra për Rajonalizim me seli në Novi Sad dhe Nëna Terezë nga Prishtina. Që të dy organizatat janë partnere të Departamentit për Demokratizim pranë Misionit të OSBE-së.

Temat kryesore të diskutuara ishin zhvillimi i projekteve të përbashkëta të OJQ-ve rinore nga Kosova dhe Serbia si dhe mundësia për ndërtimin e një partneriteti në mes të OJQ-ve rinore në rajon. 25 përfaqësues të OJQ-ve rinore nga Kosova dhe 22 nga Serbia, si dhe përfaqësues të mediave lokale dhe rajonale morën pjesë në konferencë.

Z. Fridhelm Frishenschlager, Drejtor i Departamentit për Demokratizim pranë Misionit të OSBE-së në Prishtinë, e përshëndeti takimin. Ai theksoi rëndësinë e projektit Dialogu Civil gjatë fjalimit të tij, duke nënvizuar rolin e organizatave rinore në normalizimin e marrëdhënieve dhe krijimin e një atmosfere në besimin ndërretnik në rajon.

Që të tri grupet konkluduan se ka nevojë të madhe për takime më të shpeshta të të rinjve si dhe për krijimin e një rrjeti të bashkuar funksional në rajon, i cili do bazohet në projekte konkrete. Disa projekt-propozime të përbashkëta u prezentuan grupeve punuese. Gjatë pjesës joformale të mbledhjes, pjesëmarrësit zhvilluan një diskutim interesant në lokalitetin 'Izba'.

Përshtypja e përgjithshme ishte se është bërë një hap përpara, në krahasim me takimin e parë të mbajtur në fund të gushtit të vitit të kaluar në Paliq. Labnota Hoxha, një aktiviste e OJQ-së rinore Post Pesimistët, tha, "ishte një përvojë e mirë të shohësh grupet rinore nga pjesë të tjera të rajonit duke punuar për përmirësimin e dialogut civil."

Sipas Agon Maliqit, aktivist i OJQ-së nga Prishtina, kjo konferencë nuk do të mbetet vetëm një ngjarje një-ditore, sepse do të ketë projekte përcjellëse siç është festivali muzikor. "Për mua, bisedat jo-formale që i patëm gjatë pauzave dhe gjatë ngjarjeve shpërndore ishin shumë të rëndësishme," tha Z. Maliqi.

## Më afër mediave

**Teksti: Florin Pasnicu / foto: Sandro Betaneli**

Grupi parlamentar i Komuniteteve Tjera është themeluar disa muaj më parë. Ky grup përfaqëson interesat e disa minoriteteve - ashkaliinjve, boshnjakëve, goranëve, romëve dhe turqve - dhe me 10 anëtarët e tij rradhitet si grupi i katërt më i madh në kuvend. Edhe pse mban barrë të rëndësishme politike, paraqitja publike e këtij grupi deri më tani ka qenë më e diskrete, dhe ka pas kontakte sporadike me mediat lokale.

Misioni i OSBE-së iu ka ofruar ndihmë për t'a tejkaluar këtë situatë, duke iu ofruar trajnim për çështje të mediave. Ata janë tra-

juar që nga gjërat themelore të formulimit të mesazhit publik, e deri te intervista televizive dhe komunikimi në situata kritike. Parlamentarët mësuuan edhe si t'u qasen gazetarëve dhe t'u bartin porosinë e tyre. Trajnimi ka përfunduar me një ceremoni miqësore, ku shefi i misionit të OSBE-së, Pascal Fieschi, u shërndau çertifikatat.

"I kam përmirësuar shkathëtsinë e mija mediale duke iu falënderuar këtij trajnimit," tha Z. Haxhi Zyflri Mergja gjatë ceremonisë. "Tani di më shumë për mënyrat e tërheqjes së vëmendjes së mediave," shtoi ai.

*Parlamentarë të komuniteteve të tjera shpërblehen me çertifikatë simbolike nga Shefi i Misionit të OSBE-së, në Kosovë Ambasadori Pascal Fieschi*



## Ligjërata për arsimim

Një fushatë e përbashkët mbi vetëdijësimin e publikut mëton që të bindë prindërit rom për përparësitë e arsimimit të fëmijëve të tyre.

**Teksti dhe foto: Andrej Sever**

Arsimimi i drejtë është ai për të drejtat themelore të njeriut. Pasi që një numër i madh i romëve nuk vijon shkollimin fare, ose shkojnë në shkollë rrallë, Zyra e OSBE-së në Prishtinë ka filluar një fushatë vetëdijësimi me qëllim që të informojë prindërit rom për përparësitë e shkollimit.

Sipas Z. Vojkan Milanovic, asistent në Departamentin e Demokratizimit, ky projekt është bërë së bashku me Ministrinë e Arsimit. Qëllimi përfundimtar është që të ketë në shkolla sa më shumë fëmijë rom që është e

mundur. Kjo fushatë e bërë derë më derë është duke u zhvilluar në të njëjtën kohë në Graçanicë dhe Plemetinë. Udhëheqësit e Qendrës së Romëve janë duke u zhvilluar projektin pasi sipas Z. Oliver Revah, një Zyrtar për Demokratizim, romët do t'u besojnë njerëzve të tyre.

Z. Sebastijan Sherifoviq është udhëheqës i Qendrës së Romëve në Graçanicë. "Romët kanë një shkallë të ulët të shkollimit", thotë ai. "Njerëzit të shikojnë ndryshe kur jeni i shkolluar. Të drejtat e romëve janë duke u shkelur ende sepse romët nuk janë të arsimuar", thotë Sebastijani.

Sipas drejtorit të shkollës fillore në Graçanicë rreth 10% të romëve nuk regjistrohen për çdo vit shkollor. "Ne kemi biseduar me liderët e romëve për këtë çështje. Kemi marrë premtime edhe këtë vit, sikurse edhe në të tjerët, se fëmijët rom do të ndjekin mësimet, por kam frikë se me 1 shtator, kur fillon mësimi, një numër i fëmijëve rom nuk do të ndjekin mësimet. U apelojë prindërve që mos të përsërisin gabimet që i kanë bërë prindërit e tyre dhe të lënë fëmijët pa arsimim" tha drejtori.

Janë disa raste kur problemet sociale i lënë fëmijët rom largë nga shkolla. Z. Berisha Erxhan, baba i katër fëmijëve, tha se është nga Prishtina dhe se ai dhe familja e tij janë persona të zhvendosur. Të ardhurat e vetme të kësaj familjeje janë ndihma sociale e UNMIK-ut dhe ndihma për fëmijë. "Ne i'u kemi drejtuar të gjitha organizatave humanitare për ndihmë. Gjithë çka kemi marrë janë vetëm premtime," sqaroi ai. "Po të kishim kushte normale për jetesë me siguri se fëmija im do të shkoste në shkollë, do të ishte i aftë të punojë dhe do të ishte pjestar normal i shoqërisë", tha Sanela, gruaja e Z. Erxhanit.



*Fëmijë Rom që do të duhej të ishin në shkollë dhe jo në rrugë*

## Krijoni më tepër hapsirë për femrat

Të gjitha kuvendet komunale, këtë vit kanë hapur zyrat për çështje gjinore

**Teksti dhe foto: Hasan Sopa**

Sa herë që e dëgjojmë termin barazi gjinore njerëzve u vjen në mend diçka që ka të bëjë me gjininë femrore. Prandaj mbretëron kuptimi i përgjithshëm se çështjet gjinore janë diçka që u përkasin vetëm femrave. Por, kjo definitivisht nuk është ajo që mendojnë ata që merren me këtë çështje. Sipas tyre, çështjet gjinore nuk janë çështje që u takojnë vetëm femrave, janë çështje e modelimit të rrugëve të barabarta dhe fuqizimit e meshkujve dhe femrave.

Para disa ditësh është mbajtur një trajnim për çështje gjinore, organizuar nga zyra për çështje gjinore në kuvendin komunal të Gllgocit në bashkëpunim me zyrën e OSBE-së në Lipjan. Kjo konsiderohet si një përpjekje për ndryshimin e botëkuptimit të përgjithshëm mbi barazinë gjinore. Z. Zahrie Podrimçaku, zyrtarë për çështje gjinore pranë kuvendit komunal të Gllgocit thekson, "përciptimi mbi barazinë gjinore ende nuk ka ndryshuar sa duhet, por është bërë përparim i duhur". Për ta ilustruar këtë ajo sjell ndër mend se këtë vit janë hapur zyrat për çështje gjinore pranë të gjitha kuvendeve komunale të Kosovës. Është interesantë se numri i meshkujve që marrin pjesë nëpër trajnime të tilla po shtohet dita ditës. Z. Behxhet

Binaku nga HANDIKOS-I, ishte njëri nga pjesëmarrësit e këtij seminari. Si pas tij, të dy gjinitë janë të një rëndësie të njëjtë edhe përkundër faktit se në mentalitetin tonë favorizohet më tepër gjinia mashkullore bazuar vetëm në vetitë fizike, duke lanë anash vetitë intelektuale të femrës.

Organizata të ndryshme ndërkombëtare kanë mbajtur një numër të konsiderueshëm trajnimesh mbi barazinë gjinore që nga fillimi i vendosjes së tyre në Kosovë. Por, sa më tepër që bëhet konsolidimi i institucioneve lokale edhe përgjegjësitë barten mbi supet e tyre. Njëra ndër këto organizata lokale është edhe Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore, që edhe e mbajti këtë trajnim.

Sipas z. Arjeta Rexha, Drejtoreshë Ekzekutive e organizatës, qëllimi i trajnimit është ngritja e vetëdijes së përgjithshme mbi barazinë gjinore. Ajo thekson se, "fushata mbi vetëdijësimin e popullatës janë mbajtur që nga viti 1999. Kurse tani, është momenti i vënies së mekanizimeve institucionale për mbrojtjen e çështjeve gjinore dhe për implementimin e tyre në çdo aspekt të jetës". Si duket shprehja e vjetër popullore se "po e shkollove një mashkull ke shkolluar një individ, ndërsa po shkollove një femër ke shkolluar një gjeneratë të tërë," po zë vend gjithnjë e më tepër në vetëdijen e njerëzve. Të shpresojmë se kjo praktikë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

*Pjesëmarrës të një trajnimit për çështje gjinore në Gllgoc, duke zgjidhur një problem enigme*



## Programi rinor për siguri në trafik shpëton jetëra

Që nga fillimi i programit, numri i aksidenteve fatale rrugore, ku janë përfshirë fëmijët ka rënë për 62%.

**Teksti: Ardian Spahiu / foto: Dale Samuels**

Programi Rinor për Siguri në Trafik është duke u forcuar në katër rajonet dhe përfshin mbi 300 fëmijë: 90 në Prizren, 80 në Gjiilan, 120 në Pejë dhe 22 në Mitrovicë.

Pjesëtarët e SHPK-së, në bashkëpunim me Njësinë e Komuniteteve dhe Njësinë e Komunikacionit të SHPK-së, janë duke punuar në shkollat e rajoneve. Pjesëtarët e SHPK-së i vizitojnë shkollat, ligjërojnë për programin mbi sigurinë në trafik dhe bisedojnë me arsimtarët.

Shkollat i selektojnë nxënësit që do të mësojnë sigurinë në komunikacion. Me përfundim

in e trajnimit, ata marrin mini-shenja stop dhe në disa raste edhe uniforma me qëllim që të sigurojnë kalimin e sigurt të rrugës në vendkalimet e destinuara për dhe prej shkollës.

Mbi 12.000 libra për sigurinë në rrugë u janë dhënë shkollave për sigurinë në komunikacion të themeluar prej War Child (Fëmija i Luftës), një OJQ Britaneze, dhe policëve të Shkollës së SHPK-së për Programin e Fëmijëve. Librat kanë informata të vlefshme për shenjat e trafikut, mënyrën e rregullt për përdorimin e rripit sigurues edhe si të ngjet biçikleta në mënyrë të sigurt. Kjo inicia-

tivë kurrë nuk është marrë më parë në Kosovë.

Policia Rinore për Komunikacion të Sigurtë ka vizituar gjithashtu edhe Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës që të mësojë më shumë për Sigurinë në Trafik dhe të bëjë një turne me Shkollën SHPK-së për Ndërlidhje me Komunitetin.

Analizat janë bërë me qëllim që të përcaktohet ndikimi i aktiviteteve të tilla arsimore dhe përforcimi i përgjithshëm i aktiviteteve mbi trafikun. Aksidentet fatale që përfshijnë fëmijët kanë rënë për 62%, pas fillimit të programit gjatë vitit 2002. Programi jo vetëm që ofron argëtim por edhe shpëton jetëra.



Oficer të rinj të SHPK-s dhe të rinj nga shkolla fillore të Prizrenit

## Zgjidhje afatgjate për ujin në Kufc të Epërm

Një kompani kosovare shqiptare ka punësuar pesë serb të Kosovës në rindërtimin e sistemit të ujit

**Teksti: Mustafa Skenderi**

Para konfliktit, fshatarët e Kufcës së Epërme kanë përdorur ujin e puseve të tyre për t'u furnizuar me ujë. Pas konfliktit, analizat kanë treguar përkeqësim të kualitetit të ujit nga pusët e cekta. Për t'u shmangur pasojave në shëndetin e njerëzve, gjatë dy viteve të fundit, KFOR-i ka furnizuar fshatarët me ujë të freskët me cisterna. Sidoqoftë, kjo ishte vetëm zgjidhje e përkohshme. Zgjidhja afatgjate është gjetur kah fundi i vitit të kaluar.

"Ne si bord, si dhe fshatarët e tjerë, kemi marrë pjesë në takimet me UNMIK-un dhe institucionet tjera, ku janë aprovuar vendimet për projektin e furnizimit me ujë të pijshëm. Kjo ka qenë një çështje e rëndësishme për ne, sepse 200 shtëpi nga gjithsejt 364 janë pa ujë të pijshëm," tha Z. Momcillo

Petrovic, përfaqësues i fshatit në komunën e Gjiilanit dhe anëtar i këshillit të fshatit.

'Lesna Decon', një kompani shqiptare nga Gjiilani, ka fituar tenderin në nëntor të vitit 2002 për riparimin e sistemit të ujit në fshat. Puna ka filluar në janar të vitit 2003. Kompania ka punësuar pesë serb vendor, të cilët kanë punuar në ndërtimin e rezervuarit. Kompania shoqërore Hidroteknika, ka ofruar shërbime gjeodezie dhe ekspertët kanë bërë hulumtimin në terren. Kjo kompani do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit.

I tërë projekti përbëhet nga disa faza. Faza e parë është financuar nga misioni i OSBE-së dhe ka përfshirë ndërtimin e rezervuarit prej 93 metrave kub. Rezervoari do të mbushet vazhdimisht dhe nëse konsumi do të jetë i arsyeshëm, do të ketë ujë

të mjaftueshëm për të gjitha 364 shtëpitë e fshatit. Faza e dytë - themelimi i rrjetës së ujësjellësit - duhet të financohet nga UNMIK-u. "Punimet janë paraparë të fillojnë në qershor dhe të përfundojnë në gusht 2003, dhe atëherë t'i dorëzohen Hidroteknikës," thotë Lola Ansele, zyrtare e Departamentit për Demokracizim pranë zyrës së OSBE-së në Gjiilan.

Banorët e fshatit kanë mirëpritur zbatimin e këtij projekti. Një nga fshatarët që takuam në fshat, Novica Petrovic, na tha se këto punime kanë domethënë të madhe për këtë fshat. "Kjo do të jetë një zgjidhje afatgjatë për ne. Jemi furnizuar me ujë nga pusët e cekta por sipas të gjitha gjasave, uji nuk ka qenë i shëndetshëm dhe për pije, kjo është e sigurt, sepse ahujt kanë qenë shumë afër puseve."

## Përshtypjet që do të mbesin gjatë

Vizitorët e Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës janë të impresionuar me kushtet dhe frymën multi-etnike të shkollës policore.

**Teksti dhe foto: Ardian Spahiu**

Seksioni për Ndërlidhje me Komunitetin (SNK) pranë OSBE-së që udhëheq Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovo po vazhdon me aktivitetet e saj nëpër tërë Kosovën.

Muajin e kaluar, Ekipi për Ndërlidhje me Komunitetin pranë Shkollës së SHPK-së në bashkëpunim me SHPK-në solli 48 fëmijë prej 5 fshatrave malore të Deçanit, një qytezë në jug-perëndim të Pejës. Secili nga këta fëmijë ka humbur një ose të dy prindërit gjatë armiqësive në Kosovë. Këta fëmijë ishin shumë të lumtur dhe të impresionuar me shkollën dhe mikpritjen që ua bëri stafi i shkollës dhe nxënësit. 48 fëmijët (shqiptar dhe serb) nga rajoni i Lipjanit gjithashtu vizituan shkollën e SHPK-së. Ata vinin nga dy shkolla serbe dhe një shqiptare. Ata gjithashtu ishin të shoqëruar nga 11 arsimtarë dhe dy persona më të vjetër nga dy fshatrat serbe të cilët raportuan për atë që panë atje.

Këto janë disa vizita të shkollarëve (shqiptarë, serb dhe turk) nëpër tërë Kosovën të cilët e vizituan edhe Shkollën e SHPK-së. Këta fëmijë janë të impresionuar. Gati të gjithë thonë se sa mirë është të shohësh nxënësit e përzier duke punuar, studjuar, ngrënë dhe duke u marr me aktivitetet sportive në kampin e shkollës. Kjo është se si ardhmëria duhet të jetë në Kosovë, të punohet dhe jetohet së bashku.

Përveq vizitave të organizuara në Shkollën e SHPK-së, ekipi i SNK-së shkon në terren dhe viziton komunitetet që nuk kanë mundësi që të vizitojnë këtë shkollë. Muajin e kaluar, ata vizituan shkollat serbe në Obiliq, Babimost, Crkvenavodica, Bernica e Ultë dhe Bernica e

Epërme së bashku me KFOR-in Norvegjez për katër ditë. Ata shkuanë në klasë dhe biseduan me më shumë se 300 fëmijë dhe gjithashtu ndoqën mbledhjet e prindërve që të diskutojnë mundësitë që nxënësit të vizitojnë shkollën e SHPK-së. Ja se pse egziston Policia për Komunitete. Policia janë populli dhe populli janë policija, kjo është ajo që e bënë SHPK-në siq është tani, një Shërbim Multietnik Policor që i arrin standardet më të larta demokratike.

Gjithashtu, vizita e vazhdueshme e një grupi multi-etnik nxënësisht dhe vizita e shkollës së parë serbe nga Lipjani dhe populli janë policija, kjo është ajo që e bënë SHPK-në siq është tani, një Shërbim Multietnik Policor që i arrin standardet më të larta demokratike.

Më 20 qershor, 25 serbë të rritur nga Obiliqi kan vizituar shkollën e SHPK-së. Ata ishin grupa e dytë nga qyteza e njejtë që vizitoi këtë shkollë. Prefekti i qytezës i shoqëruar prej 24 grash dhe burrash ishte i impresionuar me organizimin dhe mënyrën se si funksiononte shkolla. Pasi i bënë vizita disa klasëve derisa mësimi ishte duke u zhvilluar, ata ishin të lumtur të shohin shqiptarët, serbët dhe komunitete tjera Kosovar duke punuar së bashku për një qëllim-Kosovën multietnike.

Gjithashtu, ata patën rastin që të bisedojnë me shumë kadet serbë të cilët shprehën kënaqësinë e tyre në lidhje me jetën dhe punën që zhvillohet në shkollën e SHPK-së dhe situatën se ky vend duhet të mirret si shembull në tërë Ballkanin se si etnicitetet mund të punojnë, studiojnë, jetojnë dhe argëtohen së bashku.



Oficer të rinj të SHPK dhe të rinj nga shkolla fillore, vizitojnë shkollën e SHPK-s

## Vrapimi veror në Gjilan

**Teksti dhe foto: Andrej Sever**

Të dielën e 22 qershorit bënte mot i mirë dhe 155 vrapues, të ndarë në shtatë grupe po merrnin pjesë në Vrapimin Veror 10 kilometërsh. Njerëzit po kënaqeshin shumë duke shikuar një ngjarje të rrallë sportive dhe po u jipnin përkrahje të madhe favoriteve të tyre. Vrapuesi më i mirë doli Z. Abdurrahman Shkodra nga Pri-shtina: ai e kaloi shtegun për 32'18".

Pati vrapues nga Prizreni, Deça-

ni, Mitrovica, Suhareka, Kamenica dhe Novobërda. Një ekip i përzier i shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës nga rajoni i Gjilanit u trajnuan dy muaj nën mbikëqyrje profesionale. Miloshi, 13 vjeç, një anëtar serb i ekipit, arriti i treti në kategorinë e tij. Ai tha se për suksesin e tij i falënderohet trajnerit të tij shqiptar, Ekremi.

Një numër i madh i të punësuarëve në OSBE-së gjithashtu morën pjesë në garë. Joanne, Ecaterina, Luljeta dhe Ruperti

(42'32")- në mesin e tre më të mirëve në kategoritë e tyre- fituan shpërblyme.

Pjesa e parë e ngjarjes ishte e organizuar bashkarisht nga komuna e Gjilanit dhe Zyra e OSBE-së. Sipas Z. Srgjan Antiq, asistent në Departamentin e Demokratizimit, në vitin e ardhshëm garën do t'a organizojë vetëm komuna. "Ne do të jemi të lumtur t'u ndihmojmë atyre në çdo vështirësi që ata mund të hasin," shtoi ai.



## "Pa më shiko njëherë, unë dhe ti jemi të barabartë"

Të rinjtë nga Prizreni tërheqin vëmendjen për gjendjen e rëndë të personave me aftësi të kufizuara

**Teksti dhe foto: Hasan Sopa**

Duke parë gjendjen e rëndë të personave me aftësi të kufizuara, mosangazhimin e duhur të institucioneve ndërkombëtare e lokale dhe mungesën e vetëdijes së përgjithshme mbi këtë çështje, klubi i të rinjve për të drejtat e njeriut në Prizren, në bashkëpunim me OSBE-në, kanë hartuar një projekt me qëllim të ngritjes së vetëdijes së përgjithshme ndaj këtyre personave.

Problemet me të cilat ballafaqohen në jetën e përditshme personat me aftësi të kufizuara kanë qenë shqetësim për këta të rinj. Në grupin e tyre bëjnë pjesë 11 të rinj të shkollave të mesme të përkatesive të ndryshme etnike. Sipas Anita Shalës, udhëheqëse e këtij grupi, ideja e projektit është ngritja e vetëdijes shoqërore në përgjithësi, por edhe tërheqjen e vëmendjes institucioneve qeveritare për mosangazhimin e tyre të duhur ndaj grupeve të caktuara të njerëzve siç, janë personat me aftësi të kufizuara.

Kaltrina Rexha, nxënëse e klasës së dytë të shkollës së mesme, thotë se faza e parë e projektit është vizita që po u bëjnë familjeve me anëtarë me aftësi të kufizuara, për tu njohur më për së afërmi me problemet që ballafaqohen në

jetën e tyre të përditshme. "Gjatë këtyre vizitave ne bëjmë fotografimin e këtyre personave ku më vonë do të hapet një ekspozitë me fotografi nëpër vende publike, por edhe institucione të ndryshme publike dhe mendojmë ta ngrisin vetëdijen e qytetarëve në përgjithësi", thekson ajo.

Gjithësesi, gjëja më e prekushe për këta të rinj janë rastet që ata i hasin në teren. Nga vizita që ata i bënë familjes së Ibrahim Shalës, fshatit Ngucat komuna e Malishevës u takuan me Enver Shalën. Ibrahim tregon se biri i tij Enveri ishte smurë nga gripi kur ishte 6 vjeç dhe u shtrua në spitalin e Prizrenit. Pas katër ditë trajtimi në spital ai u shërua dhe kur të nesërmën pritej të lirohej nga spitali në mbrëmje një mjek i dha edhe një injeksion të fundit edhe pse kartela e spitalit i ishte hequr më herët. Tani Enveri është 32 vjeç dhe që nga ajo kohë ai nuk bëri më jetë normale. Kur pa se ne po i afrohem shtëpisë së tij, u gëzua shumë. Ai nuk mund të fliste por kjo vërehej në fytyrën e tij dhe kur ne u larguam, shikimi i tij na përcolli deri në fund të fshatit.

Anita Shala tregon se gjatë vizitave të bëra ka rezultuar se shumë raste janë nga mosku-

jesdia e personelit mjekësor. "Nuk e them me ndonjë përgjegjësi, por shumë raste janë nga vaksinimet e ndryshme të papërgjegjshme edhe pse nuk përjashtohen rastet e neglizhencës së prindërve që u ka kushtuar rëndë familjeve dhe personave me aftësi të kufizuara", shton ajo.

Anita porositi në radhë të parë institucionet e Kosovës, por edhe qytetarët në përgjithësi që të mendojnë për një moment se

edhe ne do të mund të ishim në vend të tyre dhe si do të ndiheshim sikur të trajtohem ndryshe nga të tjerët. "Do të ishte ndihmesë e madhe ndaj këtyre personave sikur të mund t'ju ofrojmë punë, në ato raste ku mund të bëhet kjo, sepse kjo do t'ju ndihmonte në kalimin e kompleksit që ata kanë dhe do të ju ndihmonte në integrimin e tyre si pjesë e barabartë e shoqërisë. Por, kjo varet në radhë të parë nga institucionet tona", përfundon Anita.



Ibrahim Shala dhe biri i tij Enveri

## Muzika ndërton ura

Festivali muzikor bashkoi të rinjtë e të dy anëve të qytetit në urën e Mitrovicës.

**Teksti: Sven Lindholm**

Për një natë qershori, Mitrovica nuk ishte qytet i ndarë. Ura dhe muzika i bashkuan njerëzit. Disa mijëra të rinj të të dy komuniteteve, nga jugu dhe veriu, dëgjuan muzikë dhe vallëzuan gjatë tërë natës, deri sa përfundoi programi.

Kjo ngjarje ishte manifestimi i quajtur "Fete de la Musique" organizuar nga Zyra Franceze dhe kontigjenti Francez i KFOR-it. Kjo është hera e tretë që ky festival muzikor organizohet në këtë qytet, por për dallim nga dy të parat që u zhvilluan ndarazi në veri dhe jug të lumit Ibër.

Kjo ngjarje erdhi si rezultat i insistimit të të rinjve nga të dy komunitetet, me qëllim të mbajtjes të ngjarjeve të vogla, siç janë shfaqjet teatrale në Qendrën e Kulturës dhe Kontejneri Kulturor Lëvizës dhe që të këte më shumë aktivitete multietnike. Pra, ishte vendosur që ky vit i Fete-s të zhvillohet mbi urë.

Mbrëmja filloi me një bend finlandez që bënte muzikë rok dhe rege, vazhdoi një tjetër grup finlandez, dhe pastaj DJ të njohur nga Sofja, Prishtina dhe Beogradi. Ishte një entuziazëm i madh për ata që ishin mbi urë. Ata u bashkuan për muzikë. Mund të duket si një hap i vogël, por ky ishte një hap më afër normalizimit në Mitrovicë.